

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e tretë, deri më 21.01.2024)**

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së tretë të vitit 2024 (nga 15-21.01.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **1.675 (I=91,2/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 41,7% më shumë krahasuar me javën e kaluar (n=1.182).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar (n=1.135) është regjistruar një rritje prej 47,6%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=1.267) është regjistruar një rritje prej 32,2% . (Grafiku 1)

Gjatë javës së tretë të vitit 2024, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 54 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 15 raste kanë rezultuar pozitive për Influenza, 13 Influenza A(H1)pdm09, një Influenza A(H3) dhe një Influenza A - e pasubtipizuar. Janë regjistruar 2 raste me COVID-19 dhe 3 me virus sincicial respirator (RSV).

Incidenca e raportuar është mbi kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000) (Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 1.012 persona, nga 0-4 vjet – 237, tek grupmosha nga 5-14 – 256 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 170 persona. Incidencë më e lartë (245,5/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 27 QShP/NjR: Shkup – 295, Manastir – 287, Tetovë – 165, Gostivar – 149, Dibër – 110, Kumanovë – 104, ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 100.

Nga 5 njësi raportimi që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 14 sezonal, në 3 mesatar, ndërsa në 3 i lartë dhe në 2 shumë i lartë (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e tretë 2024



Gjatë kësaj jave është regjistruar një rast i vdekjes nga gripit, person në moshë 45-vjeçare nga Negotina, i shtruar në KSIGJF, me komorbiditete (kardiovaskulare dhe pulmonare) dhe i pavaksinuar kundër gripit sezonal. Te i ndjeri është konfirmuar influenza A(H1)pdm09.


МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 5.175 (I=281,8/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=4.232) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 22,3%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=3.844) është regjistruar një rritje prej 34,6%.


Raste janë raportuar nga gjithsej 29 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (985) dhe incidencë më e lartë kumulative (5.148,4/100.000) është regjistruar në Dibër.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas QShP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 2.756 (53,3%), ndërsa incidencë më e lartë (935,5/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=903).


Grafiku 3. Shpërndarja sipas grupmoshës dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 3,8%
- nëntor – 268 raste ose 5,2%
- dhjetor – 829 raste ose 16,0%
- janar – 3.882 raste ose 75%

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezoni 2023/2024



Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 6 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi, Kumanova, Negotina, Gostivari dhe Shkupi, të grupmoshës nga 15-64 dhe mbi 65 vjet, të gjithë të hospitalizuar, me komorbiditete dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal. Tek të gjitha rastet është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e tretë, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 569 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç’rast janë detektuar 75 raste pozitive, 64 Influenza A(H1)pdm09, 6 Influenza A(H3) dhe 5 Influenza A – e pasubtipizuar.

Janë regjistruar edhe 8 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincicial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së tretë janë raportuar gjithsej 58 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve - Shkup (n=18; 31,0%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=25; 43,1%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 181, me 3 raste në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 35,0% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 45,5% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Gjatë kësaj jave është regjistruar 1 rast i vdekjes nga vendet SARI: Klinika e sëmundjeve infektive dhe gjendjeve febrile, në moshë nga 30-64 vjet. Tek i ndjeri është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09.

Kumulativisht gjatë javës së tretë për analizë laboratorike kanë arritur 36 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në 36 mostrat e analizuara tek 10 është vërtetuar prani e virusit të gripit Influenza A(H1)pdm09, në 3 mostra është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 4 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 637 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=215; 33,8%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=323; 50,7%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 3.132, nga të cilët 23 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 20,3% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 37,7% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 7 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09 ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 317 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 39 mostra është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, në 2 Influenza A(H3) dhe në 1 Influenza B e papërcaktuar dhe një 1 Influenza B/Victoria. Janë regjistruar 22 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 241 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 98 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e tretë të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 887 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.


Janë zbuluar 120 raste me Influenza:

- **Influenza A – 118 (98,3%)**

- Influenza A(H1)pdm09-105 (89,0%),
 - Influenza A(H3) – 8 (6,8%),
- Influenza A – e pasubtipizuar - 5 (4,2%) dhe
- 1 Influenza B.
- **Influenza B – 2 (1,7%)**
 - Influenza B/Victoria – 1 (50,0%)
 - Influenza B – e papërcaktuar – 1 (50,0%)

Janë regjistruar 30 raste pozitive me SARS-CoV-2, 122 me (RSV) dhe 10 me viruse të tjerë respiratorë. Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 5 raste është vërtetuar infeksion i dyfishtë (“flurona”). Janë regjistruar 129 raste pozitive me (RSV) dhe 10 me viruse respiratore të tjera.

Grafiku 5. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë aktivitet të gjerë të virusit të

influcencës. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje të gjerë gjeografike intensitet të lartë të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 58.823 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vaksina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.542 persona.

Deri në javën e tretë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.365 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e dytë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 24 nga 32 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdon të rritet, aktiviteti i COVID-19 mbetet i lartë por me tendencë për rënie, ndërsa i RSV ka filluar të bjerë.

- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV në 2 javët e fundit kanë shënuar rënie.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (98%) - A(H1)pdm09 (80%) dhe A(H3) (20%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 28% krahasuar me 29% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar ishte 21% .
- SARS-CoV-2 është në 8% krahasuar me 10% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 6% (shtrirja: 0–22%).
- RSV ishte 13% krahasuar me 17% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 6% (shtrirja: 0-28%).

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet shumë të lartë, 5 për të lartë, 14 kanë raportuar intensitet mesatar, 13 të ulët dhe 5 kanë raportua intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 25 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 6 - rajonale, 5 - sporadike, 1 - lokale.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik